



# **Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore**

## **Raport i vitit 2022**

## PËRMBAJTJA


Kapitulli I	Struktura dhe Buxheti .....	3
Kapitulli II	Integrimi Evropian dhe bashkëpunimi me Projektet .....	5
Kapitulli III	Strategjia Ndërsektorale 2022-2030 .....	6
Kapitulli IV	Praktikat e Mira .....	11
Kapitulli V	Monitorimi i planeve të integritetit në bashkitë e vendit .....	12
Kapitulli VI	Plani i Integritetit i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.	13
Kapitulli VII	Këshilli Konsultativ .....	14
Kapitulli VIII	Pjesëmarrja ne Grupe pune .....	18
	Të ndryshme	
Aneks	Monitorimi i Planeve të Integritetit sipas metodologjisë së miratuar .....	20

## KAPITULLI I

### Struktura dhe buxheti.

Organigrama dhe struktura e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, përcaktohen me Urdhër të Kryeministrit nr.17 datë 18.01.2021 “Për disa ndryshime në strukturën dhe organigramën e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore”. Struktura dhe organika e AMVV-së, aktualisht përbëhet nga 14 punonjës dhe 1 punonjës me kontratë provizore. Organigrama dhe struktura e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, për vitin 2021 është ndryshuar nga 2 sektorë në 3 sektorë me të njëjtin numër punonjësish 14.

1. Sektori e Koordinimit me Qeverisjen Vendore;
2. Sektori i Mbështetjes Institucionale;
3. Sektori i Zhvillimit.



Marrëdhëniet e punës së punonjësve të kësaj agjencie rregullohen me Kodin e Punës. Kriteret specifike dhe procedurat e pranimit në punë bëhen sipas legjislacionit në fuqi dhe nenit 14 të Rregullosës së Brendshme të AMVV-së, miratuar me urdhër të Ministrit të Brendshëm.nr.332 datë 26.10.2022.

**Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vitin 2022.**

Për vitin 2022 planifikimi dhe realizimi i buxhetit të AMVV-së është sipas tabelës.

<b>NR.LLOGARIVE</b>	<b>EMËRTIMI</b>	<b>ÇELJE NË FILLIM &amp; SHTESA</b>	<b>FAKTI MË 31/12/2022</b>	<b>FONDE TË DERDHURA NË BUXHET</b>	<b>% REALIZIMI I BUXHETIT</b>
602	SHPENZIMET OPERATIVE	10,560,00 0	4,014,657	6,545,343	38%
600	PAGAT	13,769,00 0	13,608,796	160,204	99%
601	SIGURIMET SHOQËRORE & SHËNDETËSORE	2,249,800	2,230,046	19,754	99%
231	PROJEKTI STAR 2	17,662,00 0	17,662,000	-	100%
606	TRANSFERTA PËR BUXHETET FAMILJARE DHE INDIVIDËT	280,000	244,970	35,030	87%
231	RIMBURSIM TVSH BASHKITË E FORTA	59,926,37 1	56,989,297	2,937,074	95%
231	RIMBURSIM TVSH BASHKITË PËR EVROPËN	1,511,629	1,511,629	-	100%
<b>SHUMA TOTALE</b>		<b>105,958,8 00</b>	<b>96,261,395</b>	<b>9,697,405</b>	<b>91%</b>

Mosrealizimi i buxhetit në shpenzimet operative është për arsye të:

Reduktimi i shpenzimeve sipas pikës 1, të VKM nr.160 datë 14.03.2022, të këtij vendimi, të zbatohet deri në datën kur do të shpallet përfundimi i situatës së veçantë të përcaktuar në aktin normativ nr.5, datë 12.3.2022, të Këshillit të Ministrave.

## **KAPITULLI II**

### **Integrimi Evropian dhe bashkëpunimi me Projektet**

Në kuadër të procesit të integrimit evropian ku Shqipëria ka përfituar nga mbështetja dhe ekspertiza e programit TAIEX, gjatë vitit 2022 është zhvilluar aktiviteti për organizimin e shërbimit të mbrojtjes civile. Për të përfituar nga ekspertiza dhe eksperiencia evropiane për çështjet e sipërpërmendura, u organizuan dy workshope dy ditore rajonale lidhur me “Emergjencat Civile” për të ndarë përvojat e mira nga ekspertët e vendeve të BE-së dhe përfaqësuesve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, në bashkërendim me institucionet qendrore përgjegjëse.

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore në koordinim me Ministrinë e Brendshme, Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Shkollën Shqiptare të Administratës Publike dhe me mbështetjen e Projektit “Bashkitë për në Evropë” organizoi seminare pune me njësitë përgjegjëse për emergjencat civile në njësitë e vetëqeverisjes vendore në datat 14-15 nëntor në Shkodër dhe 17-18 nëntor në Berat. Qëllimi i këtyre seminareve është ndarja e përvojave dhe praktikave më të mira të BE-së për menaxhimin e integruar të rrezikut nga fatkeqësitë dhe krijimin e një sistemi të qendrueshëm dhe bashkëpunues nëpërmjet nivelit qendror dhe atij vendor.

Të gjithë përfaqësuesit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në seminarin e punës për mbrojtjen civile shkëmbyen eksperiencat e tyre me ekspertët e huaj si dhe u njohën me praktikat më të mira evropiane për parandalimin e risqeve që vijnë nga përmblytjet, tërmetet dhe valët e nxehtësisë. Kjo krijoi një përvojë të mirë të bashkëpunimit me strukturën dhe ekspertizën evropiane, duken shenjuar një fillim të frytshëm në përshtatjen e metodave dhe proceseve të integrimit evropian.

Një pyetësor i shpërndarë online, gjatë këtij aktiviteti, vuri në pah problematikat që hasen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë ndodhjes së fatkeqësive natyrore. Në lidhje me hartën e rrezikut Shqipëria, u vlerësua nga ekspertët për inventar shumë të mirë të dhënash. Në vijim u prezantua moduli i planit të emergjencës i cili përfshinte fazat e paralajmërimit të hershëm, gatishmërisë së operatorëve, inspektimit në terren, sinjalizimit para ndodhjes së përmblytjes dhe vullnetarizimit.

## **KAPITULLI III**

### **Strategjia Ndërsektoriale 2022-2030**

Viti 2022 solli nisjen e procesit të hartimit të Strategjisë për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030, nga Ministria e Brendshme dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore. Muaji prill shenjoi formalizimin e takimeve konsultuese me Ambasadën e Zvicrës në Shqipëri dhe UNDP, si dy nga aktorët më të përfshirë në çështjet e vetëqeverisjes vendore dhe procesit e decentralizimit.

Kështu, në 21 prill u miratua vizioni, koncepti dhe afatet kohore në mbledhjen e Komitetit të Planifikimit Strategjik ndërsa në datën 22 prill me urdhër të kryeministrit nr.76 u miratua ngritja e grupeve të punës për hartimin e strategjisë. Më pas procesi vijoi me caktimin nga ana e institucioneve dhe ministrive të linjës të përfaqësuesve të tyre në grupet e punës. Ndërkaq në datën 10 maj u zhvilluan dy tryeza konsultimi me donatorët për përfshirjen e ekspertëve në hartimin e strategjisë. Për të lehtësuar gjithë procesin e punës u krijua platforma elektronike “Nyja e dijes për decentralizimin dhe qeverisjen vendore”, që do të shërbejë për konsultimin publik dhe komunikimin ndërmjet aktorëve të përfshirë. Në 17 maj u zhvillua workshopi për diskutimin e hapave që do të ndiqen sipas kalendarit të punës të miratuar nga grupi tematik i decentralizimit.

Më pas u përcaktuan dhe u miratuan termat e referencës për përzgjedhjen e ekspertëve që do të kontraktoheshin për hartimin e strategjisë, thirrja për rekrutimin e të cilëve do të hapej në 26 maj nga projekti STAR3. Në 30 maj filloi puna përgatitore për organizimin e konferencës kombëtare për decentralizimin dhe qeverisjen vendore. Gjatë javës së pare të qershorit në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë u zhvilluan takime për organizimin e konferencës kombëtare për decentralizimin dhe qeverisjen vendore. Aktiviteti u organizua në dy sesione, një për performancën financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore, ku u prezantua raporti i gjetjeve nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe sesioni i dytë i dedikuar për prezantimin e vizionit, procesit dhe afateve kohore që parashikon strategjia e re.

Në vijimësi, u organizuan takime me projektin STAR 3 dhe projektin Bashki të Forta. Gjithashtu u shpallën thirrjet për ekspertë të çështjeve vendore, që do të kontribuonin për mbarëvajtjen e procesit.

Në 6 – 10 qershor u zhvilluan takime me përfaqësuesit e Ministrisë së Financave, për organizimin e konferencës kombëtare për decentralizimin dhe performancën financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore. Në vijim, u zhvilluan takime me programet e zhvillimit STAR 3, Bashki të Forta dhe shoqatën e përfaqësuesve të çështjeve vendore, ku u ndanë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në procesin e hartimit të strategjisë.

Java e dytë e qershorit vijoi me takime me përfaqësuesit e projektit Bashki të Forta dhe u pasurua me informacion dhe dokumentacion platforma elektronike “Nyja e dijes për decentralizimin dhe qeverisjen vendore”. AMVV me mbështetjen e projektit STAR3 në datat 13 dhe 14 qershor, organizoi seminarin për prezantimin e paketës për hartimin e strategjisë, ku u simuluan ushtrime praktike për të gjithë aktorët e përfshirë në procesin e hartimit si dhe u prezantuan njohuritë dhe sugjerimet për metodologjinë që do të përdorej nga përfaqësuesit e OECD/SIGMA.

Në vijimësi të procesit në datën **17 qershor u zhvillua konferenca kombëtare për strategjinë e decentralizimit dhe qeverisjes vendore 2023-2030, e cila shënon formalisht fillimin e punës për hartimin e Strategjisë.** Në sesionin e parë u prezantuan gjetjet e analizës për performancën financiare të bashkive, duke përfshirë eficientësinë në shpenzimet e buxheteve vendore dhe nivelin e borxhit. Në sesionin e dytë u prezantua metodologjia e hartimit të strategjisë, objektivat e synuar dhe perceptimi i njësive të vetëqeverisjes vendore për kompetencat dhe funksionet.

Gjatë javës 27-30 qershor, në kuadër të procesit të hartimit të Strategjisë për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030 u organizuan tre takime me pjesëmarrjen e kryetarëve të bashkive, partnerët e zhvillimit, shoqatën për qeverisjen vendore dhe aktorët e tjerë të përfshirë. Po ashtu, në datën 29 qershor u organizua takimi me Shoqatën për Autonomi Vendore dhe kryetarët e bashkive të qarkut Elbasan ku u prezantuan të dhënat e pyetësorit të dërguar bashkive dhe këshillave bashkiake për impaktet e strategjisë së vjetër si dhe u trajtuan problematikat dhe sfidat e pushtetit vendor.

Në diskutimet e zhvilluara, **njësitë e vetëqeverisjes vendore kërkuan që në draft-strategji të përfshihen shqetësimet për mbivendosjen e kompetencave në disa fusha përgjegjësie, rritjen e transfertës financiare nëpërmjet rentës minerare dhe problematika të tjera të hasura ndër vite si ndryshimi i formulës për transfertën e pa kushtëzuar dhe shpërndarja e të ardhurave kombëtare.** Pjesëmarrësit theksuan se **ambicia për strategjinë e re 2023-2030 duhet të thellojë decentralizimin dhe qeverisja qendrore të përqëndrohet vetëm në hartimin e politikave në nivel makro, ndërsa qeverisja vendore të administrojë proceset në territor.**

Në koordinim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, në datën 30 qershor u organizua seminari, për të prezantuar analizën, gjetjet dhe rekomandimet, që do të shërbejnë si bazë për zhvillimin e dokumentave, planeve të veprimit dhe objektivave të shërbimit të menaxhimit të integruar të mbetjeve për strategjinë e re. Në këtë takim **u vlerësua zbatimi i strategjisë aktuale në fushën e menaxhimit të mbetjeve dhe u prezantua një listë me rekomandime dhe masa për strategjinë e re,** duke përfshirë plan masash dhe objektiva.

Takimi me Shoqatën për Autonomi Vendore (1 korrik 2023) dhe përfaqësuesit e bashkive të qarkut Durrës dhe Tiranë, tregoi ecurinë e deritanishme në procesin e hartimit të strategjisë së re dhe problematikat e sfidat e njësive të vetëqeverisjes vendore përgjatë kohës së zbatimit të strategjisë aktuale. Në diskutimet e zhvilluara **bashkitë theksuan nevojën për mbështetje të mjaftueshme financiare për ushtrimin dhe decentralizimin e mëtejshëm të funksioneve.**

Gjatë javës 4-8 korrik u organizuan takime rajonale me Shoqatën për Autonomi Vendore dhe kryetarët dhe përfaqësues të bashkive të qarkut Berat, Fier dhe qarkut Dibër ku u prezantuan gjetjet e pyetësorit të dërguar nga shoqata dhe u diskutua rreth draft strategjisë për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2023-2030. Në këto takime, përfaqësuesit e bashkive ngritën problematikat e hasura në ushtrimin e veprimtarisë së NJVV dhe u diskutua për mbivendosjen e kompetencave për disa nga funksionet që ushtrohen nga agjencitë e dekoncetruara të qeverisjes qendrore. Në diskutimet e zhvilluara bashkitë theksuan rëndësinë e decentralizimit të mëtejshëm të funksioneve dhe kërkuan ndryshimin e formulës së transfertës së pakushtëzuar.

Gjithashtu, në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të njësive vendore, në datën 12 korrik u organizua seminari për procesin e hartimit të një kurrikule trajnimit për nëpunësit e

administratës publike vendore në fushën e menaxhimit të mbetjeve urbane. Ky takim u organizua në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Shkollën Shqiptare të Administratës Publike me mbështetjen e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim.

Pjesëmarrësit diskutuan për analizimin dhe përditësimin e kurrikulës ekzistuese të sektorit të menaxhimit të mbetjeve urbane që disponon ASPA, me kontribute, manual, udhëzues, material trajnimi dhe praktika të hartuara nga institucione, projekte dhe donatorë të ndryshëm. Në përfundim të diskutimeve u dakortësua për një manual që do të shërbejë për hartimin e një kurrikule të unifikuar për të gjithë sektorin e menaxhimit të mbetjeve.

Në datën 13 korrik u organizua një takim pune nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe ekspertëve të kontraktuar nga STAR 3 dhe Bashki të Forta. Në këtë takim u diskutuan parashikimet e drejtimeve kryesore në procesin e decentralizimit. Të dhënat e pyetësorit drejtuar bashkive do të shërbejnë si pika orientuese për ekspertët në hartimin e draftit të parë të strategjisë.

Në fund të muajit korrik u zhvilluan takimet rajonale në Fier dhe Sarandë nga Shoqata për Autonomi Vendore dhe Shoqata e Këshillave të Qarqeve në koordinim me Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore. Në diskutimet e zhvilluara u prezantuan arritjet dhe sfidat nga bashkitë dhe këshillat e qarqeve në ushtrimin e funksioneve të tyre.

Procesi i konsultimit vazhdoi në takimet rajonale të zhvilluara nga Shoqata e Këshillave të Qarqeve për të furnizuar me të dhëna dhe gjetje grupin e ekspertëve dhe grupin teknik të hartimit të strategjisë për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2023-2030.

Gjatë javës 8-12 gusht, ekspertët përgatitën dokumentin për analizën sipas funksioneve dhe çështjeve të ngarkuara. Në këtë dokument përshkruhet situata aktuale me arritjet dhe sfidat bazuar në strategjinë aktuale të decentralizimit dhe qeverisjes vendore dhe planit të veprimit.

Gjatë javës 22-26 gusht, u zhvillua mbledhja ndërmjet kryetarit të grupit teknik të punës dhe ekspertëve të angazhuar në hartimin e strategjisë. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga PNUD dhe projekti STAR 3. Diskutimet u përqëndruan në gjetjet dhe rekomandimet kryesore për hartimin e draftit të parë të strategjisë.

Në vijimin e punës për hartimin e Strategjisë për Decentralizimit dhe Qeverisjes Vendore 2023-2030, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, organizoi një seminar pune dy ditor, 28 dhe 29 gusht, ku u paraqitën gjetjet dhe rekomandimet e pesë grupeve të ekspertëve të ndarë sipas fushave të përgjegjësisë. Raportet u diskutuan me përfaqësuesit e ministrive të linjës dhe aktorët e tjerë të përfshirë. **Ky seminar u zhvillua për 6 objektiva strategjike konkretisht në krijimin e sistemit të performancës dhe vendosjen e standarteve minimale kombëtare, administrimin e funksionit të menaxhimit të integruar të mbetjeve, administrimin publik dhe sfidat që paraqiten në menaxhimin e burimeve njerëzore, menaxhimin e funksionit të arsimit parashkollor dhe integrimin gjinor, demokracinë vendore, transparencën dhe pjesëmarrjen publike.** Grupi i punës paraqiti dokumentet e raporteve me qëllim identifikimin e arritjeve të deritanishme, mangësive, sfidave dhe problemeve të njësisë të vetëqeverisjes vendore në zbatimin e politikës së decentralizimit dhe funksioneve të qeverisjes vendore.

Dokumentat e prezantuara i paraprinë procesit të hartimit të draftit të parë të strategjisë në muajin shtator, ku në datën 6 shtator u zhvillua mbledhja ndërmjet kryetarit të grupit teknik të punës dhe moderatorëve të kontraktuar nga partnerët e zhvillimit. Në këtë takim u diskutua mbi formatin dhe strukturën e shkrimit të dokumentit të draft-strategjisë.



Drafti i parë u hartua sipas rekomandimeve të Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës. Në këtë kuadër strategjia e decentralizimit është pjesë përbërëse e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Në datën 9 shtator u organizua mbledhja me moderatorët e fushave kryesore të strategjisë të re, për të grupuar të gjitha dokumentet e hartuara nga ekspertët, duke bërë një analizë të gjetjeve të situatës aktuale dhe nxjerë rekomandimet kryesore.

Po në këtë kuadër, në koordinim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, në datën 13 shtator, u zhvillua një seminar pune për përmirësimin dhe transformimin digjital të shërbimeve administrative vendore. Seminari u organizua me mbështetjen e STAR 3 dhe ekspertëve, duke simuluar ushtrime nga praktikat e punës për digjitalizimin. Në këtë seminar me pjesëmarrje të përfaqësuesve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore u diskutua zbatimi i praktikave aktuale, nevojat dhe prioritetet për të avancuar ofrimin digjital të shërbimeve publike në bashki. Gjithashtu u diskutua për rritjen e mekanizmave të koordinimit për të avancuar digjitalizimin dhe ofrimin e shërbimeve publike.

Në datën 21 shtator u organizua nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, mbledhja e grupit teknik të punës dhe seminarit për hartimin e strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore e të planit të veprimit 2023-2030. Në këtë seminar u diskutuan gjetjet dhe analizat e kryera nga ekspertët si dhe u prezantuan objektivat që do të jenë pjesë e strategjisë së re dhe planit të veprimit. Sesioni i parë i këtij seminari u përqëndrua në analizën e funksioneve të transferuara prej vitit 2015. Mbi bazën e gjetjeve u diskutua për efektet ligjore, financiare, administrative dhe sociale në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

Në datën 22 shtator u zhvillua sesioni i dytë i mbledhjes së grupit teknik të punës ku u diskutua mbi fushat e zhvillimit ekonomik vendor dhe e demokracisë vendore, konsultimi publik e agjenda evropiane. Në këtë sesion u prezantuan gjetjet dhe analizat nga ekspertët dhe u zhvilluan diskutime me anëtarët e grupit teknik të ministrive të linjës.

Në datën 23 shtator u zhvillua një takim pune ndërmjet AMVV, Shoqatës për Autonomi Vendore dhe përfaqësuesve nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore. Në këtë takim u prezantuan gjetjet e pyetësorit drejtuar bashkive për procesin e decentralizimit dhe dokumentet e prodhuara deri tani nga ekspertët për draft-strategjinë për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2023-2030.

Një takim më i zgjeruar u zhvillua ndërmjet AMVV, Shoqatës për Autonomi Vendore, Shoqatës së Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë dhe përfaqësues të qeverisjes vendore me tematikë forumi i leadershipit vendor strategjia e decentralizimit (23 Shtator). Në këtë takim u prezantuan gjetjet, analizat, rekomandimet dhe orientimi se ku do të përqëndrohet strategjia e re e decentralizimit.

Shoqatat e të zgjedhurve vendorë, prezantuan rekomandimet e marra nga përfaqësuesit e vetëqeverisjes vendore, zyrtarët e ekzekutivit dhe përfaqësuesit nga këshillat bashkiakë dhe këshillat e qarqeve.

Ky takim shërbeu si forum diskutimi për orientimet kryesore të strategjisë për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2023-2030 në katër komponentët e përcaktuar, duke propozuar masa për arritjen e objektivave strategjike.

Përgjatë kësaj jave u zhvilluan takime me ekspertët e kontraktuar, për të diskutuar hartimin e draftit të parë të strategjisë. Përgjatë javës 3-7 tetor u zhvilluan takime me ekspertët dhe përfaqësuesit e ministrive të linjës për diskutimin e produkteve të para për hartimin e draftit të parë. Në javën 10-14 tetor u komunikua me ekspertët për shkrimin e draftit të strategjisë

për decentralizimin dhe qeverisjes vendore 2023-2030 dhe planit të veprimit. Procesi i hartimit ka përfunduar dhe në bashkëpunim me Shoqatën për Autonomi Vendore dhe projektin STAR 3 është ndjekur procesi për konsultimin e draftit me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe aktorët e tjerë të përfshirë.

Kështu gjatë 17-21 tetorit, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore organizoi takime me ekspertët e projektit STAR 3 dhe Bashki të Forta për përmbylljen e draftit të parë të strategjisë. **Në këto takime u diskutuan idetë dhe kontributet e dhëna nga përfaqësuesit e ministrive të linjës dhe insitucioneve të tjera të përfshirë në draft dokumentin mbi objektivat dhe progresin strategjik që janë parashikuar në periudhën 2023-2030.**

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore vazhdoi me takimet me ekspertët e projektit STAR 3 (24-28 tetor 2023). **Në këto takime u diskutuan materialet e përgatitura për vendosjen e standarteve minimale dhe krijimin e njësisë së vlerësimit të performancës në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Në vijimësi u diskutua për hartimin e një pakete me propozimet ligjore për rregullimin e mbivendosjes së kompetencave.**

Përgjatë javës 31 tetor- 4 nëntor, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, organizoi takime me grupin e ekspertëve të fushës së mjedisit dhe harmonizimit ligjor. Në këto takime u diskutuan dokumentet e përgatitura nga ekspertët si dhe u konsultua propozimet me ministrinë e linjës dhe institucionet përgjegjëse për mjedisin. Përgjatë javës 7-11 nëntor AMVV organizoi takim me ekspertët e OECD/SIGMA për të shqyrtuar strukturën e draftit të strategjisë, në raport me rekomandimet dhe sugjerimet e dhëna prej tyre. Në këtë kohë u plotësua paketa e masave të përfshira në planin e veprimit.

Përgjatë javës 14-18 nëntor Agjencia plotësoi draftin e strategjisë me standartet, masat për planin e veprimit dhe indikatorët e matshëm. Në këtë kuadër, grupi i ekspertëve paraqiti propozimet për standartet minimale të funksioneve të qeverisjes vendore të ndara sipas fushave të veprimit. Në vijimësi të punës së bërë u plotësua dokumenti i strategjisë me indikatorët e caktuar për çdo objektiv.

Në 21-25 nëntor u grumbulluan të dhënat dhe dokumentet nga ekspertët për indikatorët dhe masat për plotësimin e planit të veprimit, ndërsa në datën 23 nëntor në mbështetje të procesit të punës për hartimin e strategjisë, u zhvillua një takim në platformën ZOOM ndërmjet Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, AMVV, Shoqatës për Autonomi Vendore dhe projektit Bashki të Forta për diskutimin e gjetjeve dhe rekomandimeve mbi ngritjen e sistemit të menaxhimit të performancës. **Krijimi i sistemit të menaxhimit dhe njësisë së performancës, është objektivi specifik në dokumentin e strategjisë së decentralizimit dhe qeverisjes vendore, duke krijuar për herë të parë një sistem vlerësimi për veprimtarinë e bashkive në kuadër të përmbushjes së qeverisjes së mirë.**

Në datën 1 dhjetor, Agjencia në bashkërendim me Drejtorinë përgjegjëse për Çështjet Vendore përfundoi dokumentin e draftit të strategjisë, duke përfshirë propozimet e grumbulluara nga institucionet përgjegjëse ku rekomandimet e OECD/SIGMA janë mbajtur në konsideratë duke plotësuar parametrat dhe standartet teknike.

Më tej Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore shpërndau draftin e parë të strategjisë së decentralizimit dhe qeverisjes vendore 2023-2030 për konsultim me njësitë e vetëqeverisjes vendore, këshillat e qarqeve dhe anëtarët e grupit teknik të punës. Në vijim të procesit të konsultimit u zhvilluan 4 tryeza rajonale dhe një hapësirë të dedikuar në mbledhjen e fundit të vitit të Këshillit Konsultativ.

## KAPITULLI IV

### Praktikat e Mira

Në zbatim të gërmës ë, pika 4, të Vendimit të Këshillit të Ministrave “Për Krijimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetje të Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, ku Agjencia shërben si qendër evidentimi dhe promovimi të praktikave më të mira dhe/ose modeleve rekomanduese për çështjet e vetëqeverisjes vendore, në muajin nëntor 2021 nisi procesi i replikimit të praktikave të mira të NJVV.

Përkundër viteve të tjera të organizimit, këtë rradhë risia e këtij procesi ishte në shpërndarjen dhe shkëmbimin e njohurive të krijuara nga bashkitë më të zhvilluara, drejt atyre më pak të zhvilluara. **Ky ushtrim përmirësoi cilësinë e shërbimit në dy funksione bazë si menaxhimi i integruar i mbetjeve dhe mbrojtja nga zjarret.**

Agjencia me mbështetjen e programit “Bashki të Forta” u angazhua në hartimin e planit të veprimit me masa konkrete si dhe me një kalendar aktivitetesh që bënë të mundur përthithjen e këtyre praktikave nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Në aktivitetin e posaçëm të zhvilluar për fillimin e procesit të përhapjes së praktikave të mira, njësitë e vetëqeverisjes vendore, u njohën me praktikat e përzgjedhura dhe në mënyrë transparente shprehën interesin për replikimin e praktikës së bashkive Lezhë dhe Has.

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, evidentoi formularët e shprehjes së interesit, për të vazhduar më tej në cilësinë e garantuesit të procesit, me nënshkrimin e memorandumeve të bashkëpunimit ndërmjet bashkive Has, Lezhë me bashkitë replikuese. Pas nënshkrimit të marrëveshjes midis kryetarëve të bashkisë dhe AMVV janë realizuar vizita në bashkitë përkatëse për të zbatuar aktivitetet e parashikuara në planin e veprimit. Në këtë kuadër në bashkitë pjesëmarrëse janë miratuar zërat buxhetorë për realizimin e replikimit të praktikës. Gjithësej janë nënshkruar 17 marrëveshje me bashkitë e interesuara për fazën e replikimit. Ministria e Brendshme ka koordinuar të gjithë procesin me ministritë e linjës dhe institucionet qendrore mbi caktimin e ekspertëve të cilët u përfshinë për përmirësimin e dokumentacionit të praktikës.

Ekipi i caktuar me të gjithë mbarëvajtjen e procesit, ka kryer vizita në bashkitë pjesëmarrëse për tu njohur me të gjitha hapat e realizuara mbi procesin e replikimit dhe për tu siguruar për përmbylljen në afat kohor të punës.

Më tej u vijua me realizimin e workshopeve për të dyja praktikat e bashkisë Lezhë dhe Has.

Përsa i përket fazës së zbatimit të praktikës së “Mbrojtjes së Pyjeve” nga zjarret në bashkinë Has hapi i pare u vendos miratimi në këshillin bashkiak i vendimit “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e shërbimit vullnetar të bashkisë”. Më pas u realizua nga çdo bashki një fushatë informimi dhe ndërgjegjësimi në komunitet për ngritjen e shërbimit vullnetar mbi rolin dhe rëndësinë e tij. Në vijim u realizuan fushata për rekrutimin e vullnetarëve dhe u lidhën kontrata për vullnetarizmin. Pas lidhjes së kontratave u realizua trajnimi i vullnetarëve dhe informimi i institucioneve përgjegjëse për zbatimin e replikimit të praktikave.

Në lidhje me praktikën e bashkisë Lezhë, AMVV u ka dërguar të gjitha bashkive të cilat kanë përzgjedhur të realizojnë këtë praktikë, një draft rregullore për “Menaxhimin e Mbetjeve” që do të përshtatet nga të gjitha bashkitë replikuese, dhe synon krijimin e një mjedisi të favorshëm për zbatimin e legjislacionit për “Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”.

Përsa i përket procesit të menaxhimit të mbetjeve urbane ky proces synon të parandalojë çdo dëm ose rrezik për shëndetin dhe ndotjen e mjedisit nga mbetjet e ngurta urbane dhe të reduktohet ndikimi kur ai ndodh.

**Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore ka ofruar një model raportimi për menaxhimin e mbetjeve në të gjitha bashkitë replikuese.** Për këtë qëllim janë realizuar seminare ku u prezantua nga ekspertët hapat për realizimin e përshtatjes së dokumentacionit dhe proceseve të punës. Në vijimësi janë zhvilluar vizita në njësitë e vetëqeverisjes vendore për të monitoruar ecurinë e realizimit të replikimit. Në të gjitha bashkitë replikuese u dërgua formati i monitorimit dhe pyetëtori i cili duhet të ridërgohej i plotësuar brenda datës 20 qershor 2022. Të gjitha bashkitë dërguan pyetëtorin e tyre të plotësuar i cili u nda edhe me ekspertët e institucioneve përgjegjëse dhe ata të programit Bashki të Forta. Në mbyllje të procesit të replikimit u organizua takimi përfundimtar me të gjithë anëtarët e grupit të vlerësimit, të cilët u njohën me të gjitha raportet e dërguara nga bashkitë pjesëmarrëse.

## **KAPITULLI V**

### **Monitorimi i Planeve të Integritetit në bashkitë e vendit**

Në zbatim të detyrave që dalin nga Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore dhe në mbështetje të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit në 16 bashki të vendit janë hartuar dhe miratuar në këshillat bashkiake përkatës Planet e Integritetit. Për herë të parë, njësitë e vetëqeverisjes vendore shënojnë një stad ndryshimi cilësor që rrit profilin e tyre qeverisës në raport me qytetarët duke kaluar nga kodi i etikës, drejt planit të integritetit. Në këtë dokument përfshihen proceset e punës, masat për parandalimin e shfaqjeve të korrupsionit, elementët e riskut dhe indikatorët e vlerësimit të shkallës së integritetit të institucionit.

Angazhimi i AMVV për monitorimin e planeve ka konkluduar në disa gjetje. Monitorimi është kryer në 16 njësi të vetëqeverisjes vendore të cilat planet e integritetit i kanë hartuar me mbështetjen e projektit STAR3. Që në fillim të zbatimit të planit të integritetit, në këto bashki është vënë re një progres i qendrueshëm për sa i përket parametrave të transparencës dhe të uljes së riskut. Në këtë kohë është konstatuar përmirësim i menaxhimit të burimeve njerëzore, hartim për herë të parë të planeve vjetore për kualifikimin dhe trajnimin e administratës bashkiake, miratimi i kodit të sjelljes dhe janë hartuar programet e transparencës, të cilat janë të publikuara në web-faqet zyrtare të njësive të vetëqeverisjes vendore. Efektet të tjera pozitive planet e integritetit kanë sjellë në procedurat e prokurimeve publike, qartësimin e detyrave të personelit si dhe rritjen e transparencës me komunitetin veçanërisht në treguesit financiarë. Progres është konstatuar në ngritjen dhe funksionimin e njësisë së sinjalizuesve, gjithashtu është krijuar regjistri për shmangien e konfliktit të interesit dhe ai për ankesat dhe kërkesat. Agjencia ka një rol proaktiv në mbështetjen e njësive të vetëqeverisjes vendore që ende nuk e kanë nisur ose janë duke e kryer hartimin e planeve të integritetit.

Procesi i monitorimit përmbillet me përlllogaritjen e indeksit të integritetit sipas metodologjisë së miratuar. Informacion më i detajuar paraqitet në aneksin bashkëlidhur raportit vjetor të veprimtarisë së Agjencisë.

## KAPITULLI VI

### Plani i Integritetit të AMVV-së

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore në mbështetje të pikës 5, të Urdhrit nr.12, datë 21.01.2022, të Ministrit të Brendshëm “Për miratimin e Planit të Integritetit të Ministrisë së Brendshme dhe Planit të Veprimit 2022-2024” dhe shkresës nr.4206 prot., datë 26.04.2022, “Mbi hartimin e Planeve të Integritetit të institucioneve të varësisë së Ministrisë së Brendshme”, si dhe planit të punës për përgatitjen e Planeve të integritetit të institucioneve të varësisë hartoi Planin e Integritetit sipas metodologjisë së vlerësimit të riskut të integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore miratuar nga Ministria e Drejtësisë.

Plani i Integritetit i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) u mbështet në analizën e risqeve të lidhura me këtë aspekt sipas sektorëve të AMVV, duke pasur si qëllim, identifikimin dhe vënien në funksion të mekanizmave për minimizimin e faktorëve të cilët shërbejnë, si bazë për ekzistencën dhe mundësinë e korrupsionit.

Procesi i hartimit të planit të Integritetit kaloi disa faza:

*Së pari*, u ngrit grupi i punës i përbërë nga përfaqësues të strukturave të institucionit me mbështetjen e koordinatorëve të Ministrisë së Brendshme.

*Së dyti*, u zhvilluan takime të vazhdueshme të anëtarëve të grupit të punës ku u diskutua mbi vijimësinë e procesit dhe detyrat e secilit sektor të AMVV.

*Së treti*, bazuar në planin e punës të hartuar nga Ministria e Brendshme, referuar aktiviteteve /masave dhe afateve u punua për përfundimin në kohë të Planit të Integritetit dhe të Planit të Veprimit në zbatim të tij.

Grupi i punës u angazhua për përgatitjen e një analize mbi detyrat specifike të sektorëve, duke analizuar në mënyrë të hollësishme çdo aspekt dhe proces pune, i cili përfshiu disa komponentë, si më poshtë:

- Analizë e kuadrit ligjor të AMVV-së;
- Analizë lidhur me organizimin e brendshëm, përfshirë strukturën organizative;
- Analizë e procesit apo të zinxhirit vendimmarrës;
- Identifikimi i fushave, aspekteve proceseve, shërbimeve, dhe sektorëve më të ndjeshëm dhe ekspozuara ndaj korrupsionit, si dhe arsyet e identifikimit të tyre.

Në vijim të vlerësimeve për çdo sektor, informacionet u përpunuan dhe u integruan në një dokument të vetëm. Identifikimi i risqeve u krye për të gjitha proceset të vlerësuara si potencialisht të riskuara apo të ekspozuara në drejtim të cënimit të integritetit të punonjësve dhe të institucionit. Risqet e identifikuara u konceptuan dhe kategorizuan në disa grupe e fusha risku:

-në fushën e prokurimeve me vlerë të vogël;

-në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzor dhe etikës.

-në fushën e menaxhimit financiar aseteve dhe shërbimeve mbështetëse;

-në fushën e arkivimit ruajtjes dhe administrimit të dokumentacionit.

Në fund të procesit të analizës së fushave dhe proceseve të riskuara u bë integrimi i tyre dhe u hartua Matrica e Riskut të Integritetit të AMVV-së, e cila shërbeu si bazë kryesore për konceptimin e Planit të integritetit të institucionit dhe Planit të veprimit 2022-2024 në zbatim të tij. Mbi këtë bazë grupi i punës vijoi me hartimin e dokumentit të Planit të Integritetit të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe Planit të Veprimirt 2022-2024 në zbatim të tij.

Përpara miratimit drafti përfundimtar i Planit të Integritetit dhe Plani i Veprimit i'u nënshtroa procesit të konsultimit të brendshëm. Përgatitja e këtij plani synon rritjen e integritetit dhe parandalimin e korrupsionit në institucion dhe është konceptuar i shtrirë në periudhën trevjeçare 2022-2024, si dhe synon synon realizimin e disa objektivave kryesore:

- Parandalimin e korrupsionit dhe forcimin e integritetit të institucionit;
- Rritjen e transparencës së punës së sektorëve;
- Forcimin e bashkëpunimit të strukturave të brendshme në kuadër të përmbushjes së detyrimeve në fushën e antikorrupsionit.

Zbatimi i Planit të Integritetit do të nënshtrohet një procesi periodik monitorimi dhe vlerësimi, proces i cili do të kryhet nga sektori i koordinimit me vetëqeverisjen vendore.

Në kuadër të monitorimit do të përgatiten raportimet vjetore për të përcaktuar shkallën e realizimit të masave aktiviteve dhe objektivave të përcaktuara në planin e veprimit si dhe efektivitetin e tyre.

Bazuar në vlerësimin sasior dhe cilësor të arritjeve ,rrethanave ,risqeve dhe eksperiencave të mëparshme do të nxirren rekomandime për ndryshime në këtë dokument me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm në drejtim të parandalimit të korrupsionit dhe rritjes së integritetit institucional.

Pas përfundimit të periudhës 2022-2024, do të përgatitet një raport përfundimtar vlerësimi ku do të analizohen dhe vlerësohen rezultatet sipas objektivave, masave të ndërmara, efektivitetit, si dhe do të identifikohen nevojat për vijueshmërinë e masave në drejtim të luftës kundërkorrupsionit dhe ndërtimit të integritetit në sektorët e AMVV-së.

## **KAPITULLI VII**

### **Këshilli Konsultativ**

**Një drejtim i rëndësishëm i punës së AMVV është roli i saj si Sekretariat Teknik i Këshillit Konsultativ sipas përcaktimit dhe detyrave të ngarkuara ne VKM. Nr. 910, datë 21.12.2016 i ndryshuar.**

Këshilli Konsultativ si një forum konsultues ndërmjet qeverisë qendrore dhe vetëqeverisjes vendore ka institucionalizuar procesin e konsultimit midis këtyre niveleve të qeverisjes para vendimarrjes. Këshilli Konsultativ ka për objekt konsultimi të gjitha projektligjet, projektvendimet e Këshillit të Ministrave, projekt-politikat dhe projekt-strategjitë që rregullojnë ose kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve të njësive të vetëqeverisjes vendore.

**Synimi afatgjatë i krijimit dhe konsolidimit institucional të kësaj strukture është shndërrimi i organeve të vetëqeverisjes vendore në partnerë të rëndësishëm të qeverisjes qendrore për fushat e tyre të përgjegjësisë dhe të drejtave që gëzojnë.**

Në këtë raport, veprimtaria e Këshillit është analizuar në dy grupe treguesish të cilët përfaqësojnë drejtimin kryesor të punës së tij që janë nmuri i projektakteve apo dokumentave të konsultuara dhe pjesëmarrja në mbledhje si shprehje të performancës dhe efektivitetit të tij:

- I- Projekt aktet e konsultuara apo dokumenta të tjerë të shqyrtuar.
- II- Niveli i pjesëmarrjes në mbledhje nga anëtarët e Këshillit Konsultativ.

### **I-Konsultimi i projekt akteve ligjore**

Gjatë vitit 2022 në Këshilli Konsultativ është mbledhur 7 herë dhe ka konsultuar e diskutuar gjithsej 57 projekt-akte ligjore ndër të cilat 8 akte ligjore që kanë kaluar në Këshill të Ministrave pa u konsultuar në Këshillin Konsultativ. Në tërësi 47 akte janë konsultuar në mbledhjet e këshillit. Për nga aktet janë 10 projektligje, 31 projektvendime 2 projekt udhëzime, 1 projekt-urdhër, 3 strategji. Gjithashtu janë diskutuar 8 prezantime/raporte të cilat janë paraqitur në këshill. Këto projekt-akte ligjore janë paraqitur kryesisht nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, 11 prej tyre, e më tej 7 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë , 3 nga Ministria e Mbrojtjes, 4 nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, 4 nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, 3 nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, 1 nga Ministria e Kulturës, 1 nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve, 1 nga Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, 7 nga Kryeministria/Agjencitë vartëse, 8 nga Ministria e Brendshme.

Gjithashtu, janë sjellë për njohje 1 raport nga Shoqata për Autonominë Vendore, 1 raport nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 1 prezantim/projektligj nga Institutit Shqiptar për Zhvillimin Sistemit të Zgjedhjeve, 1 udhëzues nga projekti ROMACTED II për Shqipërinë, 1 prezantim nga projekti STAR 3/ IDM, 1 prezantim nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë/OSCE. Nga 47 akte të konsultuara në Këshill, 47 akte janë miratuar me vendim të bashkëkryetarëve të Këshillit Konsultativ. Ndërsa 8 aktet të cilat janë sjellë për konsultim për arsye emergjente të kalimit të tyre në Këshillin e Ministrave janë miratuar parimisht në mbledhjet e Këshillit Konsultativ duke bashkëlidhur komentet e anëtarëve dhe të NJVV.

Agjencia si Sekretariat Teknik për të lehtësuar procesin e konsultimit, është mbështetur nga projekti Bashkitë për në Evropë, duke atashuar pranë Këshillit tre ekspertë të jashtëm, të cilët ndihmojnë me paraqitjen e opinioneve dhe mendimeve profesionale, anëtarët e këshillit.

### **II-Mbi përfaqësimin e organeve të qeverisjes qendrore dhe vetëqeverisjes vendore**

Më poshtë janë paraqitur treguesit të cilët përshkruajnë nivelin e përfaqësimit në mbledhjet e Këshillit të anëtarëve të saj nga qeverisja qendrore dhe vetëqeverisja vendore. Niveli i përfaqësimit mbi bazën e të cilit janë ndërtuar këta tregues është ai i cili i ngarkohet anëtarëve të Këshillit sipas VKM-së nr. 910, datë 21.12.2016 “Për çështjet, objekt konsultimi, dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, në dy drejtime kryesore:

- (i) prania në mbledhje;
- (ii) niveli hierarkik i përfaqësuesit.

Me VKM nr.751, datë 19.12.2018, nr. 456, datë 10.6.2020 janë shtuar dhe dy ministri përgjegjëse si pjesë e anëtarësisë në këshillin konsultativ

#### **A-Niveli i përfaqësimit të organeve të qeverisjes qendrore**

Bazuar në VKM nr. 910, date 21.12.2016 “Për çështjet, objekt konsultimi, dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të këshillit konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore, kreu III “Krijimi dhe përbërja, drejtimi i këshillit konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore”, pika 7, ku përcaktohet se në përbërje të këshillit janë 22 anëtare vërehet që mesatarisht, gjatë vitit 2022 kanë qenë të pranishme në mbledhjet e këshillit konsultativ 80 % e ministrive të linjës që përfaqësohen në këshill me antarë. Nga 11 ministri që përfaqësohen në Këshillin Konsultativ, 4 prej tyre kanë qenë të pranishme në të gjitha mbledhjet, ose 36.4 % e ministrive gjithsej; 4 ministri ka qenë e pranishme në 7 mbledhje, ndërsa ministritë e tjera kanë qenë të pranishme në 2 deri 3 mbledhje.

Gjatë vitit 2022, 2 ministri kanë qenë të pranishme në Këshillin Konsultativ me përfaqësues ministrin, në 2 mbledhje, ndërsa 5 ministri janë përfaqësuar në të gjitha mbledhjet me Zv/Ministër. Me përjashtim të rasteve të mësipërme, ministritë kanë qenë të pranishme në këshill me përfaqësues të niveleve më të ulëta hierarkike. Përgjatë këtij viti siç u theksua dhe në mbledhjen e fundit të këshillit konsultativ nga Znj. Romina Kuko, Zv/Ministër, Ministria e Brendshme njëkohësisht bashkëkryetare e Këshillit Konsultativ, vërehet një pjesëmarrje jo e kënaqshme nga ministritë e linjës që janë anëtarë të përhershëm të këshillit. Vërehet një pjesëmarrje më e mire në rastet kur aktet prezantohen nga vetë ministri përgjegjës.

#### **B-Niveli i përfaqësimit të vetqeverisjes vendore**

Nga 11 anëtarët përfaqësues të organeve qeverisjes vendore, Shoqata e Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë, Shoqata për Autonominë Vendore kanë qenë të pranishme pothuajse në të gjitha mbledhjet e zhvilluara të Këshillit Konsultativ. Mesatarisht 7 anëtarë të këshillit konsultativ nga qeverisja vendore kanë qenë të pranishëm në mbledhjet e vitit 2022, që përbën rreth 63.6% e përbërjes së anëtarësisë në këshill. Ndërsa numri i pjesëmarrjes së bashkive jo anëtare të këshillit është luhatur ndjeshëm ndërmjet mbledhjeve, nga 7 në 40 bashki të pranishme. Pjesëmarrje më e lartë vërehet kur agjenda e mbledhjes përmban diskutim të akteve ligjore që lidhen me financat vendore. Mesatarisht 8 bashki kanë qenë të pranishme në mbledhjet e vitit 2022 me përfaqësues kryetarin, që përbën rreth 13.1 % të bashkive të pranishme. Pjesa tjetër, kanë qenë të pranishme me përfaqësues të niveleve më të ulëta hierarkike. Në disa mbledhje të Këshillit Konsultativ vërehet që disa anëtarë të këshillit t'Ë përcaktuar në VKM Nr. 910, datë 21.12.2016 “Për çështjet objekt konsultimi dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të këshillit konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore”, ndryshuar me vkm nr.751, datë 19.12.2018, nr. 456, datë 10.6.2020, nuk kanë marrë pjesë.

#### **Konstatime**

##### **a. Në lidhje me përfaqësimin e qeverisjes qendrore, në krahasim me kërkesat ligjore.**

Përgjithësisht, niveli i përfaqësimit në Këshill gjatë vitit 2022 të institucioneve të qeverisjes qendrore nuk ka qenë në nivelin e kërkesave ligjore për praninë në mbledhje dhe nivelin hierarkik të përfaqësuesit. Në drejtim të pranisë në mbledhje, niveli mesatar i pjesëmarrjes së



ministrive arrin në 45% ndërkohë që 27.3 % e tyre kanë qenë të pranishme në të gjitha mbledhjet. Përgjithësisht, vërehet se ministrinë, marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit vetëm nëse agjenda e saj përfshin çështje ose projekt-akte ligjore që lidhen me fushën e tyre të përgjegjësisë, ose akti prezantohet nga vete ministri përgjegjës për projektaktet e paraqitura. Ndodh shpesh që projektaktet që vijnë nga ministrinë e linjës u delegohen për prezantim drejtoresve të drejtorive apo në nivel më të ulët hierarkik.

Në drejtim të nivelit hierarkik të përfaqësuesit, vërehet një shkallë e ulët përfaqësimi me Zv/ Ministrin, përveç Zv/Ministrin të Brendshëm, njëkohësisht bashkëkryesues i mbledhjeve të këshillit. Ndërsa pjesa më e madhe e ministrive përfaqësohen me nivele më të ulta hierarkie/nivel drejtorësh ose përgjegjës sektori në pjesën më të madhe të mbledhjeve.

#### **b. Në lidhje me përfaqësimin e njërive të vetëqeverisjes vendore, në krahasim me kërkesat ligjore**

Përgjithësisht, niveli i përfaqësimit në Këshill gjatë vitit 2022 të qeverisë vendore është jo në nivelin e duhur dhe në përputhje me përcaktimet e VKM-së për përbërjen e Këshillit Konsultativ. Gjithashtu është relativisht e ulët pjesëmarrja në mbledhjet e këshillit e drejtuesve të ftuar, jo anëtarë të këshillit. Mbetet gjithashtu i ulët numri i drejtuesve të NJVV-ve që japin mendime para zhvillimit të mbledhjeve plenare për projektakte që afektojnë proceset e vendimarrjes apo vetëqeverisjes vendore.

### **C. Sekretariati Teknik i Këshillit Konsultativ**

AMVV e ka patur prioritet të punës së saj përgatitjen, organizimin dhe mbarëvajtjen e mbledhjeve të Këshillit Konsultativ në zbatim të VKM-së 910, datë 21.12.2016 " "Për çështjet, objekt konsultimi dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore i ndryshuar", përcaktohet se *roli i Sekretariatit Teknik të Këshillit Konsultativ kryhet nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.*

Sekretariati ka mundur plotësimin e kërkesave procedurale në realizimin e 7 mbledhjeve të Këshillit Konsultativ përgjatë vitit 2022 edhe si pasojë e prurjes së madhe të akteve për konsultim nga ministrinë e linjës. Sekretariati Teknik gjatë vitit 2022 ka kryer të gjitha detyrat që ka në këtë kuadër duke garantuar infrastrukturën dhe komunikimin e nevojshëm për përgatitjen e për zhvillimin normal të seancave plenare të Këshillit Konsultativ. Kjo punë fillon me dërgimin e dokumentave për njohje dhe konsultim para ditës së zhvillimit të mbledhjes, mbledhja e mendimeve dhe përgatitja e materjaleve për bashkryetarët dhe dosjeve për çdo anëtar të ftuar. Në përfundim përgatitet drafti i vendimeve të mbledhjes dhe pasi siglohet u dërgohet institucioneve që kanë paraqitur projekte për konsultim së bashku me sugjerimet e këshillit, për t'u hapur rrugë procedurave pasardhëse të miratimit.

I gjithë ky proces për secilën mbledhje mbart edhe përgatitjet logjistike që garantojnë zhvillimin normal të seancave. Theksojmë se vazhdimësia e paraqitjes së akteve nga institucionet qendrore krijon mbivendosje të punës për dy mbledhje të njëpasjëshme.

Puna sistematike dhe respektimi i afateve të parashikuara për proceset nga të gjithë sektorët kanë bërë të mundur zhvillimin normal dhe të dokumentuar të veprimtarisë së Këshillit Konsultativ.

## **KAPITULLI VIII**

### **Pjesëmarrja në grupe pune për hartim dokumentash e punonjësve të AMVV:**

Gjatë vitit 2022 stafi i AMVV ka qënë i angazhuar apo përfaqësuar sipas delegimit nga drejtuesit, në grupe pune ndërinstucionale për hartimin e dokumentave që kërkojnë në zbatim kontributin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

AMVV ka dhënë kontributin e vet konkret në grupe pune:

#### **1. Ndërinstucionale**

- a. Hartimi i Strategjisë Kombetare të Drejtësisë për të Mitur. (Ministria e Drejtësisë)
- b. Hartimi i Planit Kombëtar të Emergjencave Civile. (AKMC)
- c. Hartimi i Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve. (Ministria e Turizmit dhe Mjedisit)
- d. Task Forca për menaxhimin e Sezonit Turistik ( Ministria e Turizmit dhe Mjedisit )

#### **2. Ministria e Brendshme**

- a. Ligj “Për Policinë Bashkiake”.
- b. Strategjia Kombëtare për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030.

### **Grupe pune për monitorim pranë NJVV për probleme të veçanta:**

AMVV me urdhër të vecantë të Drejtorit të Përgjithshëm i cili ishte anëtar i Grupit të Punës së MB për monitorimin e sezonit turistik veror 2022, organizoi disa grupe pune dhe një kalendar për monitorimin e plotësimit të detyrimeve të NJVV për sezonin turistik sipas kërkesave të planit të veprimit përkatës, ku AMVV ishte institucion bashkëraportues për dy prej detyrave. Përfaqësues nga AMVV kanë marrë pjesë në disa mbledhje të komiteteve

lokale ( rajonale ) të zhvillimit të turizmit të thirrura nga prefektët e qarqeve, ku janë diskutuar masat që aktorët vendore dhe degët territoriale të qeverisjes qendrore marrin në kuadër të sigurimit të parametrave sa më cilësorë për të gjitha aspektet dhe kërkesat e sezoneve turistike me specifikat përkatëse të çdo zone.

Për këtë grupet zhvilluan vizita monitoruese në 13 bashkitë që kanë dhe kufi ujor bregdetare gjatë gjithë sezonit veror të turizmit. Konstatimet dhe problematikat e vërtetuara janë prezantuar drejtuesve të NJVV përkatëse dhe janë raportuar në takimet e Grupit të Punës të MB. Një përmbledhje e gjetjeve janë përfshirë në një raport për sezonin turistik veror AMVV ka ndjekur gjithashtu nga afër ecurinë e aksionit kombëtar të pastrimit duke u fokusuar në plotësimin e detyrave që NJVV kishin në këtë kuadër.

Vlerësimi për një sezon turistik të suksesshëm veror gjatë vitit 2022 dhe sidomos përmirësimi drastik i situatës së pastrimit veçanërisht në zonat e plazheve ishte rezultat edhe i një preokupimi serioz nga NJVV dhe monitorimit, evidentimit dhe bashkëpunimit për zgjidhje të problematikave nga AMVV.

## **TE NDRYSHME**

Gjatë vitit 2022 AMVV ka ushtruar brenda detyrës së saj institucionale komunikimin shkresor dhe elektronik me të gjitha NJVV të vendit si dhe me institucione të administratës qendrore kryesisht për probleme që lidhen me vetqeverisjen vendore, por edhe problematika të rolit të saj si Sekretariat Teknik apo bashkëpunime të ndryshme institucionale. Çdo korespondencë shkresore është e dokumentuar dhe protokolluar sipas rregullave të administrimit apo arkivimit. Në mënyrë periodike Agjencia ka bërë raportimet e kërkuara nga Ministria e Brendshme në lidhje me aktivitetin javor, objektivat strategjike, masat e paraqitura në planin 300 ditor, indikatorët e përcaktuar si dhe për çdo aktivitet të deleguar nga drejtuesit.

## ANEKS

### **Raportim i vitit 2022 në lidhje monitorimin e zbatimit të planeve të integritetit në nivel vendor.**

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) në kuadër të funksioneve të saj për realizimin e objektivave të Qeverisë Shqiptare për garantimin e qeverisjes së mirë, kryen procesin e monitorimit të hartimit dhe zbatimit të planeve të integritetit në nivel vendor. Në këtë kuadër, AMVV ka marrë pjesë në procesin e hartimit dhe konsultimit të këtyre planeve duke u mbështetur nga ana teknike dhe metodologjike nga projekti STAR3, i bashkëfinancuar nga Qeveria Shqiptare. Bashkitë tani kanë në përdorim metodologjinë e Planit të Riskut të Integritetit dhe Kodin Standard të Sjelljes. Kjo përfshin (a) përgatitjen e metodologjisë së Planit të Riskut të Integritetit dhe Kodit Standard të Sjelljes, si dhe (b) hartimin, proceset e konsultimit, rishikimin dhe finalizimin e dokumenteve të sipërpërmendura.

Përsa i përket angazhimit në procesin e monitorimit të realizimit të treguesve të planeve të integritetit të bashkive gjatë vitit 2021, AMVV duke u koordinuar me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) që kishin miratuar Planet e Integritetit, realizoi procesin e monitorimit të zbatimit të planeve të tyre të veprimit. Monitorimi u krye në bashkitë Mat, Gjirokastrë, Elbasan, Patos dhe Mallakastër. Kuadri analitik për vlerësimin e zbatimit të planeve të integritetit në nivel vendor përfshin tre fusha kryesore, të cilat përbëjnë bazën kryesore për vlerësimin e planeve të integritetit në bashkitë e përzgjedhura:

1. **Fusha e parë:** Sistemi i menaxhimit të integritetit në institucion - Procese dhe rregullore të qarta - 15 tregues.
2. **Fusha e dytë:** Burimet njerëzore të përshtatshme, të kualifikuara dhe të trajnuara për t'i rezistuar shkeljeve të integritetit - 11 tregues.
3. **Fusha e tretë:** Transparencë më e lartë e bashkisë me publikun dhe aktorët përkatës - 11 tregues

**Ndërkaq ky instrument metodologjik nuk është më në përdorim** sepse për monitorimin e zbatimit të planeve të integritetit nga bashkitë është hartuar me mbështetjen e projektit STAR III **metodologjia e Indeksit të Integritetit**, një instrument diagnostikues më kompleks që merr për bazë shkallën e kërcënimit (risqet) të integritetit që paraqesin aktivitete dhe fusha të ndryshme të veprimit të pushtetit vendor. Nëpërmjet tij realizohet vlerësimi i integritetit të bashkisë duke kombinuar dy instrumente metodologjike a) Vetë – Vlerësimi i Integritetit Institucional nga njësia e vetëqeverisjes vendore dhe b) Vlerësimi i Integritetit të institucionit nga publiku.

Kuadri analitik për vlerësimin e zbatimit të planeve të integritetit në nivel vendor përfshin pesë fusha kryesore dhe 75 indikatorë të vlerësuar me 5 pikë maksimale secili (pra një total maksimal prej 375 pikësh), të cilat përbëjnë bazën kryesore për vlerësimin e planeve të integritetit në bashkitë e përzgjedhura.

- (i) **Sjellja, etika dhe menaxhimi i konfliktit të interesit** (20 tregues )
- (ii) **Praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore** (15 tregues)
- (iii) **Menaxhimi i burimeve financiare** (15 tregues)
- (iv) **Shërbimet për publikun** (10 tregues)
- (v) **Pronat, zhvillimi territorial dhe ekonomik** ( 15 tregues)

**Kompleksiteti i këtij kuadri të ri analitik, dyfishimi i numrit të treguesve dhe pikëzimi i tyre, jep një rezultat më konkret e më të detajuar por që njëkohësisht ka një luhajtje të lehtë nga rezultatet e monitorimit të vitit 2021 sidomos përsa i përket bashkive të mëdha.** Rezultati përfundimtar (Indeksi) shërben si instrument i standartizuar për të realizuar krahasueshmërinë mes njërive të vetëqeverisjes vendore në lidhje me parametrat e qeverisjes

së mirë, për vendosjen dhe zbatimin e parimeve dhe standarteve më të mira në dobi dhe në interes të qytetarëve. Ky rezultat do të shërbejë si baseline dhe orientim për përmirësimin e mëtejshëm të performancës së bashkive në lidhje me qeverisjen e mirë dhe luftën kundër korrupsionit.

Për procesin e hartimit të Planeve të Integritetit, nëpërmjet Projektit STAR III, AMVV ka ndihmuar në hartimin e tyre në disa bashki. Në këtë kuadër, janë mbajtur sesione informuese për çështjet që bashkitë i kanë ngritur gjatë zbatimit të planeve të integritetit. Nga janari 2022 deri në fund të dhjetorit 2022, 14 ( katërbëdhjetë ) plane integriteti u finalizuan dhe u miratuan në Këshillat Bashkiakë të Tiranës, Pogradecit, Beratit, Përmetit, Belshit, Bulqizës, Lezhës, Pukës, Kavajës, Himarës, Kukësit, Maliqit, Shijakut, Hasit. Në Janar të 2023, u miratua Plani i Integritetit i bashkisë Roskovec, ndërkohë dy plane shtesë të integritetit përkatësisht planet e bashkive Lushnje dhe Librazhd janë duke u hartuar dhe pritet t'u nënshtrohen një diskutimi përfundimtar me grupet e punës përkatëse.

Tabela e mëposhtme pasqyron listën e bashkive që kanë miratuar Planet e Integritetit në Këshillat Bashkiak si edhe stadin e kryerjes së proceseve të monitorimit të zbatimit të tyre nga Agjencia.

**Tabela 1**

Nr.	Bashkia	Nr VKB	Data e miratimit	Statusi aktual i monitorimit
1	Elbasan	4	04.12.2019	Monitoruar
2	Patos	82	13.12.2019	Monitoruar
3	Mallakastër	109	20.12.2019	Monitoruar
4	Mat	59	24.12.2019	Monitoruar
5	Gjirokastrë	11	31.01.2020	Monitoruar
6	Durrës	127	28.10.2021	Në proces monitorimi
7	Belsh	10	31.01.2022	Monitoruar
8	Përmet	6	31.01.2022	Monitoruar
9	Bulqizë	300	01.02.2022	Monitoruar
10	Pogradec	18	18.02.2022	Monitoruar
11	Berat	9	02.03.2022	Monitoruar
12	Pukë	33	03.03.2022	Në proces monitorimi
13	Lezhë	32	04.04.2022	Në proces monitorimi
14	Tiranë	35	06.04.2022	Monitoruar
15	Kavajë	52	24.05.2022	Në proces monitorimi
16	Himarë	28	27.05.2022	Monitoruar
17	Kukës	35	31.05.2022	Monitoruar
18	Maliq	54	31.05.2022	Monitoruar
19	Shijak	20	07.06.2022	Monitoruar
20	Has	44	29.06.2022	Në proces monitorimi
21	Roskovec	4	27.01.2023	

Për sa i përket zbatimit të PI-ve, AMVV, ka koordinuar punën me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) që kanë miratuar tashmë një Plan Integriteti, për të monitoruar zbatimin e tij gjatë vitit 2022 duke përdorur instrumentin e Indeksit të Integritetit. Procesi u zhvillua në

të gjitha bashkitë që kanë hartuar planin e integritetit sipas listës më sipër. Fillimisht u informuan bashkitë dhe u nda me to kalendari i procesit të monitorimit si edhe kuadri analitik udhëzuesit dhe formularët përkatës, për t'i paraprirë në mënyrë efektive një procesi korrekt, transparent dhe llogaridhënës. Kështu, procesi i monitorimit të zbatimit të planit të veprimit u fokusua fillimisht në bashkitë Mat, Gjirokastër, Elbasan, Patos, Mallakastër dhe më pas në bashkitë sipas tabelës 1. Ndërkohë monitorimi nuk ka mbaruar në bashkitë Durrës, Lezhë, Kavajë dhe Has ku është ende në procesin e grumbullimit të informacionit.

**Informacioni mbi zbatimin e planit të integritetit në nivel bashkie grumbullohet nëpërmjet dy instrumenteve që mund të përdoren edhe në mënyrë të pavarur:** të formularit të Vetë - Vlerësimit të Integritetit Institucional i plotësuar nga stafi i bashkive sipas fushave përkatëse dhe pyetësorit të Vlerësimit të Integritetit të bashkisë i plotësuar nga publiku, i shpërndarë nga bashkitë në pikat e kontaktit me publikun si edhe on-line. Në rastin konkret është përdorur **instrumenti i Formularit të Vetë - Vlerësimit të Integritetit Institucional në mënyrë të pavarur**, i pa shoqëruar me Pyetësorin e Vlerësimit të Integritetit nga Publiku. Pyetësori i Vlerësimit të Integritetit nga Publiku është menduar që të plotësohet me një distancë kohore nga Formulari i Vetë - Vlerësimit të Integritetit Institucional për të lejuar që publiku të marrë kohën e duhur për një vlerësim të drejtë e të paanshëm të integritetit të bashkisë.

Sipas rezultateve, indeksi i integritetit të bashkive kategorizohet në:

**Tabela 2: Kategorizimi i Indeksit të Integritetit**

<b>Nivelet e Klasifikimit</b>	<b>Vlerësimi i kuantileve sipas pikëve totale</b>	<b>Vlerësimi i nivelit të integritetit vendor</b>
<b>I</b>	1 – 75 pikë	Integritet shumë i ulët
<b>II</b>	75 – 150 pikë	Integritet i cenueshëm
<b>III</b>	150 – 225 pikë	Integritet i moderuar
<b>IV</b>	225 – 300 pikë	Integritet i lartë
<b>V</b>	Mbi 300 pikë	Integritet i pacenueshëm

Ndërkaq një përmbledhëse e rezultateve të performancës së bashkive në zbatimin e masave të Planit të Integritetit gjatë vitit 2022 sipas fushave jepet si më poshtë në tabelën 3 ku bëhet edhe një renditje në rend zbritës i rezultateve.

**Tabela 3**

<b>Bashkia</b>	<b>Fusha 1 (pikë) Sjellja, etika dhe menaxhimi i konfliktit të interesit (20 indikatore) Max 100 pikë</b>	<b>Fusha 2 (pikë) Praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore (15 indikatore) Max 75 pikë</b>	<b>Fusha 3(pikë) Menaxhimi i burimeve financiare (15 indikatore) Max 75 pikë</b>	<b>Fusha 4 (pikë) Shërbimet për publikun (10 indikatore) Max 50 pikë</b>	<b>Fusha 5 (pikë) Pronat, zhvillimi i territorit dhe ekonomik ( 15 indikatore) Max 75 pikë</b>	<b>Total bashkia Max 375 pikë</b>
<b>Bulqizë</b>	95	70	60	45	70	340
<b>Kukës</b>	95	60	60	50	60	325
<b>Tiranë</b>	100	55	55	50	60	320
<b>Berat</b>	95	70	55	35	55	310
<b>Përmet</b>	95	75	45	50	40	305
<b>Mat</b>	95	65	55	35	50	300
<b>Pogradec</b>	100	70	50	40	40	300
<b>Maliq</b>	95	70	70	35	30	300
<b>Elbasan</b>	95	70	60	35	35	295
<b>Belsh</b>	100	70	55	30	35	290
<b>Gjirokastrë</b>	90	70	55	40	30	285
<b>Pukë</b>	95	70	45	30	40	280
<b>Patos</b>	90	75	55	25	25	270
<b>Shijak</b>	95	75	50	30	25	265
<b>Mallakastër</b>	70	50	55	40	45	260
<b>Himarë</b>	80	50	45	35	40	250

Siç mund të shikohet Performanca e të gjitha bashkive përfshihet në intervalin “integritet i lartë” (225-300 pikë).

Tabela 3.1


Nr	Kategorizimi i Bashkive	Bashkia	Fusha 1 (pikë) Sjellja, etika dhe menaxhimi i konfliktit të interesit (20 indikatorë)	Fusha 2 (pikë) Praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore (15 indikatorë)	Fusha 3 (pikë) Menaxhimi i burimeve financiare (15 indikatorë)	Fusha 4 (pikë) Shërbimet për publikun (10 indikatorë)	Fusha 5 (pikë) Pronat, zhvillimi i territorit dhe ekonomik (15 indikatorë)	Max 375 pikë
			Max 100 pikë	Max 75 pikë	Max 75 pikë	Max 50 pikë	Max 75 pikë	
1	<i>Bashki të Mëdha</i>	Tiranë	100	55	55	50	60	320
2		Elbasan	95	70	60	35	35	295
3		Gjirokastrë	90	70	55	40	30	285
4		Berat	95	70	55	35	55	310
5		Pogradec	100	70	50	40	40	300
6		Kukës	95	60	60	50	60	325
7	<i>Bashki të Mesme</i>	Maliq	95	70	70	35	30	300
8		Shijak	95	75	50	30	25	265
9		Patos	90	75	55	25	25	270
10		Mat	95	65	55	35	50	300
11	<i>Bashki të Vogla</i>	Belsh	100	70	55	30	35	290
12		Përmet	95	75	45	50	40	305
13		Bulqizë	95	70	60	45	70	340
14		Pukë	95	70	45	30	40	280
15		Himarë	80	50	45	35	40	250
16		Mallakastër	70	50	55	40	45	260

### Renditja e përgjithshme e bashkive sipas performancës në zbatimin e Planit të Integritetit dhe 5 fushave të tij

Nga tabela 3 evidentohet që performancën e përgjithshme më të lartë në zbatimin e masave të Planit të Integritetit e ka bashkia Bulqizë, e ndjekur nga bashkia Kukës dhe Tiranë.


Bashkitë **Tiranë**, **Pogradec** dhe **Belsh** kryesojnë në fushën 1 Sjellja, etika dhe menaxhimi i konfliktit të interesit. Në fushën 2 Praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore kryesojnë bashkitë **Përmet**, **Shijak** dhe **Patos**, në fushën 3 Menaxhimi i burimeve financiare kryeson bashkia **Maliq**, në fushën 4 kryesojnë bashkitë **Kukës**, **Përmet** dhe **Tiranë**, dhe në fushën 5 Pronat, zhvillimi i territorit dhe ai ekonomik, performancën më të mirë e ka bashkia **Bulqizë**. Një paraqitje më e detajuar e renditjes së bashkive sipas performancës në lidhje me zbatimin e masave dhe realizimin e treguesve të Planit të Integritetit institucional, gjatë vitit 2022 si edhe vlerësimi përkatës në pikë jepet nga grafiku më poshtë:






Monitorimi sipas fushave të veçanta të performancës jep këto rezultate:

### Fusha 1 Sjellja, etika dhe menaxhimi i konfliktit të interesit




Monitorimi i fushës 1, tregon nivel më të mirë zbatimi nga bashkitë Tiranë, Pogradec dhe Belsh.

## Fusha 2 Praktikrat e menaxhimit të burimeve njerëzore




Monitorimi i performancës së bashkive përsa i përket indikatorëve të fushës 2, Praktikrat e menaxhimit të burimeve njerëzore, tregon performancë optimale të bashkive Përmet, Shijak dhe Patos (75 pikë ose 100%).

## Fusha 3 Menaxhimi i burimeve financiare




Monitorimi i performancës së bashkive përsa i përket indikatorëve të fushës 3, Menaxhimi i burimeve financiare rendit bashkinë Maliq si bashkinë me performancën më të mirë, e ndjekur nga bashkitë Elbasan, Kukës, Bulqizë.

#### Fusha 4 Shërbimet për publikun Fig 5. Fusha 4 Shërbimet për publikun



Nga monitorimi i performancës së bashkive përsa i përket indikatorëve të fushës 4, Shërbimet për publikun rezultojnë se bashkitë Kukës, Përmet dhe Tiranë kryesojnë dhe janë në të njëjtin nivel performancë, të ndjekura nga bashkitë e tjera.

#### Fusha 5 Pronat, zhvillimi i territorit dhe ekonomik



Nga monitorimi i performancës së bashkive përsa i përket indikatorëve të fushës 5, Pronat, zhvillimi territorial dhe ekonomik rezultojnë se bashkia Bulqizë ka nivelin më të lartë të performancës, e ndjekur nga bashkitë Tiranë e Kukës.

Përqindja e zbatueshmërisë së masave të planit të integritetit për të 16 bashkitë llogaritet si më poshtë në tabelën 4:

**Tabela 4: Zbatueshmëria e masave të planit të integritetit në përqindje për të 16 bashkitë**

<b>Nr</b>	<b>Bashkia</b>	<b>Total bashkia Max 375 pikë</b>	<b>Rezultati në %</b>
<b>1</b>	<b>Bulqizë</b>	340	90.1
<b>2</b>	<b>Kukës</b>	325	86.6
<b>3</b>	<b>Tiranë</b>	320	85.3
<b>4</b>	<b>Berat</b>	310	82.6
<b>5</b>	<b>Përmet</b>	305	81.3
<b>6</b>	<b>Mat</b>	300	80
<b>7</b>	<b>Pogradec</b>	300	80
<b>8</b>	<b>Maliq</b>	300	80
<b>9</b>	<b>Elbasan</b>	295	78.6
<b>10</b>	<b>Belsh</b>	290	77.3
<b>11</b>	<b>Gjirokastrë</b>	285	76
<b>12</b>	<b>Patos</b>	270	72
<b>13</b>	<b>Mallakastër</b>	260	69.3
<b>14</b>	<b>Himarë</b>	250	66.6
<b>15</b>	<b>Pukë</b>	280	74
<b>16</b>	<b>Shijak</b>	265	70.6
<b>Përqindja mesatare</b>			<b>78.14</b>

Përqindja mesatare llogaritet si mesatarja aritmetike e shumës së përqindjeve të zbatueshmërisë së masave të planeve të integritetit të të gjitha bashkive. Në përfundim, **përqindja mesatare e zbatueshmërisë së Planeve të Integritetit në bashkitë e monitoruara për vitin 2022 është 78.14%.**